



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE**  
**LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**  
**KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**  
**Nr.484, datë 14.10.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PROCEDURAT E DHËNIES**  
**DHE RINOVIMIT TË LIÇENCAVE PROFESIONALE PËR SUBJEKTET**  
**JURIDIKE E FIZIKE QË USHTROJNË VEPRIMTARI NË SEKTORIN E**  
**FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË**  
**NDOTURA”**

Në zbatim të neneve 10, dhe 14 dhe 19 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, për “Kudrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.302, date 11.05.2022 ”Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator, duke qenë se riorganizimi i shoqërive UK në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP-UK), sjell ulje të numrit të shoqërive aktuale njëkohësisht dhe uljen e të ardhurave në buxhetin e ERRU-së si dhe duke patur parasysh periudhën kalimtare të transferimit të tyre në SKP-UK:

**VENDOSI:**

1. Në Aneksin nr. 5 të Vendimit nr. 29, datë 08.12.2009 i Komisionit Kombëtar Rregullator “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar, pas fjalëve të titullit, sipas Kategorive të përcaktuara me VKM Nr.958, datë 06.05.2009....shtohet “për shoqëritë UK që ende nuk janë riorganizuar sipas VKM nr.302, date 11.05.2022”.
2. Pas Aneksit nr. 5 të Vendimit nr. 29 datë, 08.12.2009, të Komisionit Kombëtar Rregullator “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar, shtohet Aneksi me nr. 5/1 me titull “Sipas kategorive të përcaktuara me VKM Nr.958, datë 06.05.2009 për shoqëritë të riorganizuar sipas VKM Nr.302, date 11.05.2022.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë UK, shoqëritë Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta Ujësjellës-Kanalizime si dhe të gjitha strukturat e ERRU-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Ndriçim Shani**

**PAGESAT PER LIÇENCIM**

1. Sipas kategorive te percaktuara ne Vendim Nr. 958 date 06.05.2009 për shoqëritë të riorganizuar sipas VKM Nr.302, date 11.05.2022.

POPULLSIA E ZONES SE MBULIMIT	PAGESAT			
	Kategoria A, grumbullimin dhe shperndarjen e ujit per konsum publik	Kategoria B, per perpunimin e ujit per konsum publik	Kategoria C, per largimin e ujrave te ndotura	Kategoria D, per perpunimin e ujrave te ndotura
50.000 - 100.000 banorë	60,000	60,000	60,000	60,000
100.000 - 150.000 banorë	80,000	80,000	80,000	80,000
150.000 - 200.000 banorë	120,000	120,000	120,000	120,000
200.000 – 500.000 banorë	150.000	150.000	150.000	150.000
Mbi 500.000 banorë	170.000	170.000	170.000	170.000
Ndryshim Drejtuesi Ligjor	40.000			
Ndryshim Drejtuesi Teknik	40.000			

**Shënim:** Operatorët do të bëjnë pagesat sipas tabelës së mësipërme në rast ndryshimi të kategorisë së shërbimit, të popullsisë në zonën e shërbimit apo ndryshim drejtuesi ligjor dhe/ose Teknik.